

Vendim nr. 135 datë 21.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 21.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (P) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: PAL GJINAJ

OBJEKTI: Shkelja e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe kalimi i çdo afati ligjor të dhënies së drejtësisë në favor të kërkuarit.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*);

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Pal Gjinaj (*kërkuesi*) dhe shoqëria “Gjoni” sh.p.k. në datën 04.04.1996 kanë lidhur një marrëveshje, përmes së cilës kjo shoqëri ka marrë përsipër të ndërtojë për llogari të kërkuesit një vresht me sipërfaqe 2.1 ha, sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga ana e saj. Sipas marrëveshjes në fjalë, kjo shoqëri merrte përgjegjësi të plotë deri në momentin e zënies së vreshtit, si dhe do të siguronte asistencë teknike dhe atë të shërbimeve.

2. Për sigurimin e fondeve për realizimin e vreshtit, në datën 21.05.1996, ndërmjet kërkuesit dhe Bankës Tregtare Agrare (BTA), është lidhur një kontratë huaje për shumën 5.179.500 lekë, për krijim vreshti e shërbimesh dhe blerje mjetesh bujqësore (motokultivator). Në këtë kontratë përcaktoheshin afatet dhe mënyra e lëvrimit të shumës së mësipërme, si dhe specifikoheshin se shuma do të disbursohej me urdhërxhirim në llogarinë e sipërmarrësit kundrejt situacioneve të paraqitura dhe inspektimit që do të kryhej prej BTA-së.

3. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me kërkesëpadi me objekt përmbushjen e detyrimit kontraktor dhe shpërblimin e dëmit, ku palë të paditura janë shoqëria “Gjoni” sh.p.k. dhe BTA-ja. Kërkuesi ka pretenduar se shoqëria “Gjoni” sh.p.k. nuk ka realizuar të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar prej tyre, si dhe BTA-ja nuk e ka lëvruar të gjithë fondin e dhënë hua. Në kërkesëpadi, ai ka kërkuar: detyrimin e të paditurve për të përcaktuar detyrimin e tij ndaj BTA-së, dega Laç, lidhur me punimet e kryera në zbatim të vendimit nr.13, datë 20.05.1996 të Bankës së Përgjithshme Tregtare Agrare, Tiranë, si dhe detyrimin për vazhdimin e lëvrimit të kredisë. Duke qenë se çështja objekt gjykimi lidhet me disa procese gjyqësore, vlerësohet që të parashtrihen të ndara.

Procesi i parë gjyqësor

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 359, datë 02.12.1997, ka vendosur detyrimin e BTA-së (Banka e Kursimeve Dega Laç) të vazhdojë disbursimin e kredisë së paditësit sipas kontratës së huas së datës 21.05.1996, për pjesën e mbetur, si dhe detyrimin e shoqërisë “Gjoni” sh.p.k. t’i kthejë këtij të fundit shumën 126.400 lekë si punime të pakryera.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 734, datë 08.04.1998, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr. 1288, datë 17.11.1998, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

Procesi i dytë gjyqësor

6. Kërkuesi ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 359, datë 02.12.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, duke pretenduar se ekzistojnë rrethana nga ato të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), që e bëjnë të cënueshëm vendimin e dhënë, pasi ai është bazuar në dokumente të falsifikuara dhe vlera e punimeve të pakryera nga pala e paditur, shoqëria “Gjoni” sh.p.k., është më e madhe se vlera e pranuar me vendimin e mësipërm.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 216, datë 05.07.2000, ka vendosur rrëzimin e padisë, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1315, datë 13.11.2001, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 216, datë 05.07.2000 dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

8. Në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë është pranuar si e provuar se mbi bazën e kallëzimit të paditësit ka filluar një procedim penal, gjatë së cilit është realizuar akti i ekspertimit grafik dhe është dalë në përfundim për falsitetin e dokumentit mbi të cilin është bazuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin në dhënien e vendimit nr. 359, datë 02.12.1997. Konkretisht, bëhet fjalë për dokumentin “Fletëdalja nr. 3”, datë 10.05.1996, ku është pasqyruar në mënyrë fiktive shpenzimi prej 50.000 lekësh për blerjen e motokultivatorit. Nga hetimi penal ka rezultuar se nënshkrimi nuk është i kërkuesit dhe se urdhërshirimi nëpërmjet të cilit BTA-ja ka disbursuar shumën prej 3.600.000 lekësh në llogarinë e sipërmarrësit, është nxjerrë si pasojë e një procedure të parregullt.

9. Gjatë rigjykimit të çështjes, kërkuesi ka kërkuar ndryshimin e objektit të padisë si pasojë e humbjes së interesit për vazhdimin e kontratës mes palëve. Kërkimet e paditësit në rigjykim kanë qenë: 1) zgjidhja e kontratës së datës 04.04.1996 të lidhur midis tij dhe shoqërisë “Gjoni” sh.p.k.; 2) detyrimi i të paditurit, shoqërisë “Gjoni” sh.p.k., t’i kthejë të paditurit, BTA-së, vlerën 3.600.000 lekë; 3) detyrimi i të paditurve t’i kthejnë kërkuesit shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mospërbushja e detyrimeve kontraktore.

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 450, datë 26.09.2003, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, ndryshimin e vendimit civil nr. 359, datë 02.12.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, duke vendosur zgjidhjen e kontratës së datës 04.04.1996 të lidhur ndërmjet kërkuesit dhe firmës “Gjoni” sh.p.k., si dhe detyrimin e kësaj të fundit dhe BTA-së, Dega Laç (Agjencia e Trajtimit të Kredive (ATK), Tiranë), që të dëmshpërblejnë në mënyrë të barabartë kërkuesin në shumën 26.745.416 lekë, pasi nga ana e të paditurit, shoqëria “Gjoni” sh.p.k., nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet e marra përsipër në kontratë, si dhe janë gjetur parregullsi e

shkelje nga ATK-ja (ish-BTA) lidhur me lëshimin e urdhrave të xhirimit. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim palët e paditura, shoqëria “Gjoni” sh.p.k. dhe ATK-ja.

11. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 784, datë 21.06.2004, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 450, datë 26.09.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, duke pranuar padinë e kërkuarit dhe duke vendosur shkarkimin e tij nga detyrimi për t’i paguar ATK-së kredinë e marrë në shumën 4.708.205 lekë principali dhe 7.746.874 lekë interesat. Kundër këtij vendimi, kërkuari ka ushtruar rekurs, duke pretenduar se gjykata nuk është shprehur për dëmin plus fitimin e munguar.

12. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1553, datë 10.11.2005, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 784, datë 21.06.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë asaj gjykate, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se gjatë rishqyrtimit të saj gjykata e apelit ishte e detyruar t’i jepte përgjigje të gjitha pretendimeve të paraqitura nga paditësi, pasi gjykimi në këtë rast fillonte nga e para.

Procesi i tretë gjyqësor

13. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1261, datë 06.12.2006, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 450, datë 26.09.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, duke përcaktuar detyrimin e palës së paditur, shoqërisë “Gjoni” sh.p.k., të paguajë për llogari të kërkuarit kredinë e marrë prej tij me kontratën e huas të datës 21.05.1996, në masën 4.708.205 lekë, sikurse edhe interesat që rridhnin prej saj. Kundër këtij vendimi, kërkuari ka ushtruar rekurs, përmes të cilit ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar, ndër të tjera, se gjykata e apelit nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë.

14. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 409, datë 03.12.2009, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1261, datë 06.12.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues, pasi ky kolegji e ka konsideruar të mangët arsyetimin e gjykatës së apelit lidhur me vlerën e dëmit, për të cilin është detyruar pala e paditur.

Procesi i katërt gjyqësor

15. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1117, datë 20.05.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 450, datë 26.09.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me ndryshimin që cakton detyrimin e të paditurit, shoqërisë “Gjoni” sh.p.k., që të dëmshpërblejë

kërkuesin në shumën 45.816.186 lekë. Kundër vendimeve nr. 1117, datë 20.05.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 450, datë 26.09.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, shoqëria “Gjoni” sh.p.k. ka ushtruar rekurs, ndërsa kërkuesi ka paraqitur kundërrekurs.

16. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 204, datë 15.05.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1117, datë 20.05.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se në rigjykimin e çështjes Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka zbatuar udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë, të cilat konform neneve 486 e 493 të KPC-së janë të detyrueshme në rishqyrtimin e çështjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka udhëzuar Gjykatën e Apelit Tiranë që duke mbajtur parasysh përfundimet e këtij vendimi, qoftë edhe kryesisht, të përsërisë hetimin gjyqësor.

Procesi i pestë gjyqësor

17. Në procesin e rigjyimit, në zbatim të udhëzimeve dhe detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur riçeljen e hetimit gjyqësor, duke vendosur kryerjen e ekspertimit dhe duke administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse. Në seancën gjyqësore të datës 25.05.2015 kërkuesi ka kërkuar pushimin e gjykimit ndaj palës së paditur, shoqërisë “Gjoni” sh.p.k. si dhe shpërblimin e dëmit vetëm ndaj palës së paditur, ATK-së, në masën 77.120.346 lekë, i cili konsiston në vlerën maksimale të nxjerrë nga akti i ekspertimit, përkatësisht në dëm efektiv dhe fitim të munguar.

18. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1336, datë 29.05.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 450, datë 26.09.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe ndryshimin e vendimit nr. 359, datë 02.12.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin si vijon: (1) zgjidhjen e kontratës së datës 04.04.1996 të lidhur ndërmjet kërkuesit dhe të paditurit, shoqërisë “Gjoni” sh.p.k.; (2) detyrimin e të paditurit, shoqërisë “Gjoni” sh.p.k. për t’i paguar të paditurit, ATK-së, për llogari të kërkuesit, kredinë e marrë prej tij mbi bazën e kontratës së huas të datës 21.05.1996, në masën 3.600.000 lekë, si dhe interesat përkatëse mbi këtë shumë dhe kërkuesi mbetet debitor ndaj ATK-së për diferencën e kredisë së mësipërme, si dhe interesat përkatëse mbi të. Ndërkohë që, gjykata ka vendosur rrëzimin e pjesës tjetër të padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Kundër këtij vendimi, në datën 28.06.2015, kërkuesi ka ushtruar rekurs. Shoqëria “Gjoni” sh.p.k. ka ushtruar gjithashtu rekurs në datën 06.07.2015. Ndërkohë që ATK-ja ka ushtruar kundërrekurs në datën 10.07.2015 ndaj rekursit të kërkuesit, duke kërkuar mospranimin e tij.

19. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2927 (319), datë 19.09.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1336, datë 29.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues. Kjo gjykatë ka arsyetuar se në procesin e rigjykimit, Gjykata e Apelit Tiranë duhet të plotësojë detyrat e lëna në vendimin nr. 204, datë 15.05.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe të qartësojë përfundimisht vullnetin e kërkuarit, se cilës palë të paditur ia drejton pretendimet për shpërblim dëmi.

20. Kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykatës*) në datën 25.05.2023 me ankim kushtetues individual për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe kalimin e çdo afati ligjor të dhënies së drejtësisë në favor të tij.

II

Pretendimet e kërkuarit

21. **Kërkuarisi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të:

21.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi proceset gjyqësore për çështjen objekt gjykimi kanë zgjatur për 26 vjet dhe sërish Gjykata e Lartë e ka kaluar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku nuk dihet fati i gjykimit të saj.

21.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në paragrafin e tretë të vendimit nr. 00-2022-2927 (319), datë 19.09.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është disponuar: “Në kuadër të një projekti të hartuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin rezulton një nxitje nga Kryetari i Kuvendit Popullor të kohës (viti 1995) për ndërtimin e një vreshti dhe një kantine me fonde që do t’i jepeshin Institutin e Kërkimeve të Pemëve Frutore dhe Vreshtave Tiranë për Krijimin e Vreshtit [...] Kjo kontratë e lidhur me IKPFVT nuk ka filluar nga zbatimi [...]”, ndërkohë që ky fakt i reflektuar në këtë vendim është i deformuar. Kërkesa e kërkuarit nuk është bërë me nxitjen e Kryetarit të Kuvendit, por mbi bazën e projekteve të prezantuara. Kryetarit të Kuvendit i është dërguar shkresë, lidhur me pengesat e hasura dhe përgjigja e tij zyrtare drejtuar kërkuarit dhe për dijeni palës kundër të cilit ai ankohej, nuk mund të quhet nxitje ose ndikim ndaj kësaj pale në favor të tij. Janë programet e FAO-s që kanë qenë nxitje për ekonominë

e tregut edhe në fushën e agrobiznesit, ndaj përdorimi i termit “nxitje” nuk duhet të jetë pjesë e arsyetimit të kësaj gjykate.

21.3. *Parimit të hetimit të plotë e të gjithanshëm*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në faktet dhe provat e dosjes gjyqësore, si dhe duke konstatuar paefektshmërinë e kolegjeve paraardhëse dhe të gjykatës së apelit për të përfunduar një gjykim me vendim të formës së prerë për 26 vjet, duhet ta zgjidhte vetë çështjen objekt gjykimi, duke lënë në fuqi vendimin nr. 450, datë 26.09.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

22. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

23. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

24. Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

25. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të

gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

26. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 13, datë 09.03.2021; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, duke i parashtruar një kërkim në objekt, i cili lidhet me shkeljen e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe kalimin e çdo afati ligjor në dhënien e drejtësisë, që ka lidhje me proceset gjyqësore të zhvilluara nga gjykatat ndër vite për çështjen objekt gjykimi. Ndërkohë që, në përmbajtjen e ankimit të tij janë ngritur pretendime të tjera, që, në thelb, lidhen me vendimin nr. 00-2022-2927 (319), datë 19.09.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1336, datë 29.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

28. Lidhur me kërkimin në objektin e ankimit kushtetues, për cenimin e të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Kolegji sjell në vëmendje se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ku është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete

ligjore/instrumente efektive për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të cilat, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për sa më lart, Kolegji vëren se, sipas akteve bashkëlidhur kërkesës, këtë pretendim kërkuar e ka parashtruar drejtpërdrejt përpara Gjykatës, duke mos shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive që ai ka pasur në dispozicion sipas neneve 399/1–399/12 të KPC-së. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit, duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se kërkuar nuk i ka përdorur këto mjete ligjore për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Si rrjedhim, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim, pasi kërkuar nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion.

31. Kolegji çmon gjithashtu se pretendimet e tjera që lidhen me vendimin nr. 00-2022-2927 (319), datë 19.09.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk mund të merren në vlerësim, pasi ky vendim nuk ka vendosur në mënyrë përfundimtare për çështjen. Procesi gjyqësor mbi objektin e gjykimit vazhdon ende të gjykohet në themel nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, ky vendim nuk mund të konsiderohet përfundimtar, në kuptim të vendimit gjyqësor për të cilin janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi kërkuar i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rishqyrtimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Mbështetur në standardet e mësipërme kushtetuese dhe referuar rrethanave të rastit në shqyrtim, në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj në themel nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriterin paraprak të shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe neni 71/a,

pika 1, shkronja a, të ligjit nr. 8577/2000. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.